

V E N D I M
Nr.81, datë 18.2.1999

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.335, DATË 2.9.1997
“PËR PAJISJEN ME PASAPORTË SHËRBIMI DHE DIPLOMATIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.335, datë 2.9.1997 bëhen këto ndryshime:

a) në pikën 3 shtohen këto paragrafe:

“- Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit;

- Kancelari në Gjykatën e Lartë;

- Zëvendësministrat;

- Ndihmësi i kryeministrit dhe zëvendëskryeministrit;

- Drejtorët e Departamenteve dhe kryekoordinatori në aparatin e Këshillit të Ministrave;

- Koordinatorët e Departamentit të Koordinimit në aparatin e Këshillit të Ministrave;

- Bashkëshortja e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese;

- Bashkëshortja e kryetarit të Gjykatës së Lartë;

- Bashkëshortja e prokurorit të Përgjithshëm;

- Bashkëshortja e kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit;

- Bashkëshortja e sekretarit të Përgjithshëm në Presidencë;

- Oficerët e shoqërimit të prokurorit të Përgjithshëm dhe të kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”

Pas mbarimit të funksionit të tyre

- Ish-Presidenti i Republikës;

- Ish-Kryetari i Kuvendit;

- Ish-Kryeministri;

- Ish-zëvendëskryeministri;

- Ish-ministri i Punëve të Jashtme;

- Ish anëtarët e Këshillit të Ministrave për një periudhë 5-vjeçare, mbas mbarimit të funksionit;

b) Fjalët “anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve” shfuqizohen.

2. Në pikën 4 bëhet këto ndryshime:

a) Shtohen këto paragrafë:

“- Drejtorët e drejtorive në Presidencë;

- Drejtorët e drejtorive në Gjykatën Kushtetuese;

- Drejtorët e drejtorive në Prokurorinë e Përgjithshme;

- Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;

- Kryetari i Institutit të Integritetit të të Përndjekurve Politikë dhe drejtorët e drejtorive në këtë Institut;

- Drejtori i shkollës së Magjistraturës;

- Punonjësit e sektorit të marrëdhënieve me jashtë të Kuvendit;

- Dy gazetarë të Departamentit të Informacionit në ATSH;

- Dy gazetarë të Departamentit të Informacionit në Radio;

- Dy gazetarë dhe dy kameramanë të Departamentit të Informacionit në TVSH”.

b) Fjalët “zëvendësministrat” dhe “drejtori i Departamentit në aparatin e Këshillit të Ministrave” shfuqizohen.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme të hartojë dhe të paraqesë për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, aktet përkatëse për përcaktimin e kriterëve dhe mënyrën e pajisjes me “Pasaportë speciale” të disa kategorive të caktuara në fushën e artit, kulturës, shkencës, sportit, biznesit etj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko